

**"UFO" SHPK - NIPT J82025002B**

Bulevardi "Zogu i Pare, ish Pallati i Kultures "Ali Kelmendi", Tiranë

---

**VENDIM**

**I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË "UFO" sh.p.k**

Sot, më datë 01.02.2021, ne ambientet e shoqërisë "UFO" SHPK me NIPT J82025002B, në adresën *Bulevardi "Zogu i Pare", ish Pallati i Kultures "Ali Kelmendi" Tiranë*, unë Ortaku i Vetëm i shoqërisë, **Z.Astrit Veliaj**, i biri i Ferikut, dtl.08.04.1958, lindur dhe banues ne Tirane, mbajtës i Letërnjoftimit Nr. Personal F80408148C,

**V E N D O S A**

1. Caktimin e Zj. Amanda Gjyli, Administratore e shoqërisë "UFO" sh.p.k, shtetase shqiptare, e lindur më 22.05.1988 në Berat, madhore dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, në cilësinë e përfaqësueses së ortakut të vetëm të shoqërisë "UFO" sh.p.k., regjistruar me NIPT J82025002B, Z. Astrit Veliaj, në Mbledhjen e thirrur të Asamblesë së Përgjithshme, të shoqërisë "HOTEL COLOMBO BERAT" sh.p.k.
2. Zj. Amanda Gjyli, i jepen tagra të plota të përfaqësimit dhe vendimmarrjes në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "HOTEL COLOMBO BERAT" sh.p.k., në përputhje me Rendin e ditës dhe vendimmarrjet që janë bashkëlidhur këtij vendimi si Aneks 1.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË  
UFO sh.p.k**

**Astrit VELIAJ**

*Astrit Veliaj*



Vendimi nr. 3

Datë 01/02/2021

### VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË "HOTEL COLOMBO BERAT" sh.p.k

Sot, më datë 01/02/2021, në ambientet e shoqërisë "HOTEL COLOMBO BERAT" SHPK. në adresën: Hotel Colombo Berat, Rruga "Santa Luçia", lagja nr. 2, Ndërtesa nr. 6, Berat, në vijim të njoftimit e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme bazuar në statutin e shoqërisë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të Vetëm të shoqërisë "HOTEL COLOMBO BERAT" sh.p.k, e krijuar në funksion dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë QKB me NUIS M12519002F.

I pranishëm në mbledhje është ortakut i vetëm i shoqërisë, i cili përfaqëson 100% të pjesëve të kapitalit të shoqërisë:

Shoqëria "UFO" sh.p.k., regjistruar me NIPT J82025002B, përfaqësuar nga Zj. Amanda Gjyli, shtetase shqiptare, e lindur më 22.05.1988 në Berat, madhore dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, në cilësi të përfaqësueses së ortakut të vetëm të shoqërisë.

Asambleja e Ortakut të vetëm të Shoqërisë "HOTEL COLOMBO BERAT" sh.p.k, shqyrtoi temat e mëposhtme të rendit të ditës:

për të shqyrtuar dhe vendosur mbi çështjet e mëposhtme të rendit të ditës:

#### **Rendi i ditës**

1. Miratimi i ndryshimit të nenin 13 të Statutit të shoqërisë duke u riformuluar si më poshtë vijon:

#### **"Administratori"**

- 13.1 *Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.*
- 13.2 *Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve.*

---



- 13.3 *Administratori, bazuar në një vendim të asamblesë së ortakëve, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.*
- 13.4 *Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve".*
2. Duke qenë se shoqëria në vijim, në bazë dhe të ndryshimeve statutore, do të ketë vetëm një administrator, shkarkimin e administratorit ekonomik Zj. Adelina Veliaj;
3. Emërimin e administratorit Zj. Anisa Veliu me nr. personal I65222070F për një afat 5 (pesë) vjeçar për periudhën 27.01.2021 deri në 26.01.2026, e cila do të ketë kompetenca për administrimin e shoqërisë sipas të drejtave dhe kufizimeve në nenin 13 të statutit të shoqërisë.
4. Miratimin e shtimit të emrave tregtar: "Colombo Travel" dhe "Agjenci Imobiliare Colombo".

Pas diskutimit mbi çështjet e rendit të ditës, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar,

#### **U VENDOS:**

- 1. Miratimi i ndryshimit të nenit 13 të Statutit të shoqërisë, duke u riformuluar si më poshtë vijon:**

#### **"Administratori**

- 13.1 *Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.*
- 13.2 *Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve.*
- 13.3 *Administratori, bazuar në një vendim të asamblesë së ortakëve, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.*
- 



13.4 Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.

2. Shkarkimi i Administratorit Ekonomik Zj. Adelina Veliaj;
3. Emërimin e administratorit Zj. Anisa Veliu me nr. personal I65222070F për një afat 5 (pesë) vjeçar për periudhën 27.01.2021 deri në 26.01.2026, e cila do të ketë kompetenca për administrimin e shoqërisë sipas të drejtave dhe kufizimeve në nenin 13 të statutit të shoqërisë;
4. Miratimin e shtimit të emrave tregtar: "Colombo Travel" dhe "Agjenci Imobiliare Colombo".
5. Ky vendim të depozitohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe ligjit 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve në të dhënat e regjistruara të shoqërisë.

**ORTAKU I VETËM**

**UFO sh.p.k**

**Administrator**

**Amanda GJYLI**

*Amanda Gjyli*

